

VENDIM
Nr.384, datë 25.5.2011

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.53, DATË 21.1.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR NGARKIMIN E MINISTRISË SË BRENDSHME PËR KRYERJEN
E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PUBLIK, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË
KRYEMINISTRISË, MINISTRIVE DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, PËR DISA
MALLRA DHE SHËRBIME”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 11 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “b” të pikës 2 të kreut I të vendimit nr.1, datë 10.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 të vendimit nr.53, datë 20.1.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht lejohet Ministria e Mbrojtjes t’i realizojë vetë procedurat e prokurimit për:

- a) Blerje uniformash, veshmbathjesh dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;
- b) Blerje këpucësh.”.

2. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha